

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"GD PLAST" SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z. Elton Gagani, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 09/08/1980, lindur në Durres, banues në Durres, Lagjja nr.1, Rruga: Taulantia, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. personal I00809066G
- Z. Ervin Gagani, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 29/03/1977, lindur në Durres, banues në Durres, Lagjja nr.1, Rruga: Taulantia, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. personal H70329066F
- Z. Xhulio Dako, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 02/01/1995, lindur në Durres, banues në Durres, Lagjja nr.3, Rruga: Tregtare, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. personal J50102071P

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", sot me datë 23/03/2021 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "GD PLAST SH.P.K". Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare "GD PLAST SH.P.K", ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "GD PLAST SH.P.K", do të ketë zyrën e saj qendrore në: Durres, Xhafzotaj, Autostrada Durres - Tirane, prane mbikalimit të Fllakes, Zona Kadastrale 2574, objekt me numer pasurie 159/79



3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Prodhim qese plastike, flete polietilene për bujqësi, import-eksport.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31/Dhjetor/2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "GD PLAST" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "GD PLAST" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "GD PLAST" SHPK është 600.000 (gjashtëqind mijë) Leke, e ndarë në 3 kuota, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z - ELTON GAGANI, është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje është e barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 180.000 (njqind e tetëdhjetë mijë) Leke
- Z - ERVIN GAGANI, është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje është e barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 180.000 (njqind e tetëdhjetë mijë) Leke

- Z – XHULIO DAKO, është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje është e barabartë me 40% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 240.000 (dyqind e dyzet mijë) Leke

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. ELTON GAGANI.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.


Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Elton Gagani



Z. Ervin Gagani



Z. Xhulio Dako



Dt. 23.03.2021